



TREGU I SHITJES ME SHUMICE TE FRUTA-PERIMEVE

TEL/FAX ++3558243262

ASAMBLEJA E AKSIONEREVE TE SHOQERISE

VENDIM

Nr. 23, date 29.03.2011

Mbi miratimin e Statutit te Sh.A. "Tregu i shitjes me shumice te fruta-perimeve,, te pershtatur me kerkesat e Ligjit 9901, date 14 04 2008.

Ne zbatim te Ligjit 9901, date 14 04 2008, "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare,,neni 135, pika 2, germa b. Asambleja e Aksionereve te Shoqerise, pas shqyrtimit te relacionit te paraqitur , si dhe te projekt statutit te Shoqerise, mbas diskutimesh dhe ne baze te koopedencave qe ka :


VENDOSI

1. Te miratoje statutin e Shoqerise "Tregu i shitjes me shumice te fruta-perimeve"
2. Ngarkohet Drejtoria e Shoqerise te kryeje veprimet prane Q.K.R-se Korce

Per Keshillin e Bashkise
Kryetar
Gjergji Pendavinji



STATUTI I SHOQERISE
“Tregu i shitjes me shumice te Fruta – Perimeve Korçë” SHA



Neni 1

Forma, Emertimi i Shoqerise, selia dhe kohezgjatja.

Shoqeria krijohet ne formen e Shoqerise Anonime ne baze te ligjit shqiptar “Per shoqerite tregtare”

Emertimi i Shoqerise eshte “ Tregu i shitjes me shumice te fruta-perimeve Korçë”SH A.

Selia e shoqerise eshte prane ish-UMB Korçë, Shqiperi.

Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj dhe te hape filialet e veta ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

Aktiviteti tregtar i Shoqerise do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

Neni 2

Aksioneri themelues

Themeluesi i Shoqerise eshte Bashkia e Qytetit te Korçës në bazë të nenit 95 të ligjit « Për Shoqëritë Tregtare», te ligjit nr. 8652, date 31.7.2001 “Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” dhe me vendim të Keshillit Bashkiak Nr. 27 date 04.05.2004 (konfirmuar nga Prefektura me shkresen Nr. 829 prot., date 17.05.2004) ka autorizuar krijimin e kësaj Shoqërie.

Neni 3


Objekti i Shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Ngritja dhe funksionimi i tregut te shitjes me shumice te prodhimeve bujqesore te fresketa.
- Dhenia me qera e hapësirave dhe ambienteve te tregut me shumice individeve dhe firmave qe tregtojne prodhime bujqesore te fresketa, kryesisht fruta dhe perime;
- Dhenia me qera e hapësirave dhe ambienteve individeve dhe firmave qe sigurojne sherbime te ndryshme per perdoruesit e tregut me shumice, me qellim qe aktiviteti i tyre tregtar te jete sa me eficient;
- Nxitja e shitjes te prodhimeve bujqesore lokale, duke organizuar aktivitetet perkatese si panaiere, ekspozita, si dhe promovimi i prodhimeve lokale gjate gjithe vitit.
- Shoqeria siguron transparence per transaksionet tregtare qe zhvillohen brenda tregut me shumice. Ajo grumbullon dhe shperndan te dhena per tregun tek te gjitha palet e interesuara. Shoqeria bashkepunon ngushte me te gjitha inspektorat perkates dhe autoritetet ekzekutive publike per te siguruar qe:
 - transaksionet qe zhvillohen ne tregun me shumice te behen ne perputhje me ligjin,
 - perdoruesit e tregut te kene licensen qe kerkon ligji
 - prodhimet qe tregtohen ne treg te plotesojne te gjitha kerkesat sipas ligjit.



- Shoqeria rregullon funksionimin e tregut me shumice nepermjet nxjerrjes te Rregullores se Brendeshme dhe nese eshte e nevojshme bashkepunon me autoritetet publike perkatese.



Neni 4

Kapitali - Aksionet

Ne castin e krijimit te Shoqerise, kapitali themeltar i shlyer ne leke eshte 2 000 000 Leke (dy milion leke), i ndare ne 2 000 aksione me vlere nominale 1 000 (nje mije) leke secili. Kontributi eshte shlyer plotesisht nga aksioneri.

Neni 5

Zmadhimi i kapitalit

Kapitali themeltar zmadhohet me vendim te Asamblese se Pergjitheshme te Jashtezakonshme te Aksionereve mbi baze e raportit te drejtorise. Statuti i Shoqerise ndryshohet me perputhje me kete rritje.

Ne rastin e rritjes se kapitalit me kontribute ne natyre me vendim gjykate caktohet nje ekspert per kontributet, ne perputhje me *Nenet 162, 168, 169* te ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

Rritja e kapitalit duhet te perfundoje brenda 5 (pese) vjeteve nga data kur Asambleja ka mare nje vendim te tille (*Neni 153* I ligjit te shoqerive)

Neni 6

Zvogelimi i kapitalit te shoqerise

Zvogelimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve dhe zvogelimi i prek te gjithe aksioneret ne te njejten mase, ne perpjesetim me aksionet qe zoterojne ne shoqeri ne baze te *Nenit 164* te ligjit te shoqerive.

Drejtoria I dorezon Asamblese se mbledhur per marrjen nje vendimi mbi zvogelimin e kapitalit nje raport te arsyetuar, I cili pershkruan rrethanat qe kane bere te detyrueshem zvogelimin e kapitalit.

Zvogelimi I kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar te pakten 45 (dyzet e pese) dite perpara mbledhjes se Asamblese Pergjitheshme qe thirret per te vendosur mbi zvogelimin e kapitalit.

Neni 7

Transferimi i pronesise se aksioneve


Per nje periudhe 5 vjecare, Aksioneri i vetem, Bashkia e qytetit te Korçes, nuk do te beje asnje transferim te pronesise se aksioneve. Pas kesaj perudhe, ne rastin kur aksioneri deshiron, mund te transferoje pronesine mbi nje pjese te aksioneve te tij; jo me shme se 49 % te tyre investitoreve private, dhe jo me shume se 5 % per cdo investitor, duhet te mare miratimin e Keshillit Bashkiak.

Neni 8

Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te Shoqerise jane:

- 1) Asambleja e aksionereve;
- 2) Keshilli mbikqyres;
- 3) Drejtoria



Neni 9

Asambleja e aksionereve

Asambleja e Aksionereve eshte organi me i larte i Shoqerise. Ajo vendos mbi te gjitha ceshtjet e Shoqerise dhe vendimet e saj jane te detyrueshme per aksioneret.

Vetem Asambleja e Jashtezakonshme e Shoqerise ka te drejte te ndryshoje statutin me te gjitha dispozitat e tij. Cdo klauzole tjeter eshte e pa vlefshme.

Asambleja e pergjithshme thiret nga Keshilli Mbikqyres. Mbledhjet e Asamblese mund te thirren gjithashtu nga Drejtoria, nga Ekspertet Kontabel te autorizuar te Shoqerise, nga nje perfaqesues i autorizuar nga gjykata ose nga Likuiduesi, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Asambleja e Zakonshme thirret te pakten nje here ne vit, brenda gjashte muajve pas mbarimit te vitit fiskal. Ne mbledhjet e saj, Asambleja e Zakonshme diskuton dhe miraton raportin financiar vjetor te Shoqerise. Raportin vjetor financiar e paraqet Drejtoria. Ky raport diskutohet fillimisht ne Komitetin Konsultativ te Tregut, miratohet nga Keshilli Mbikqyres dhe verifikohet nga Ekspertet Kontabel. Ajo gjithashtu diskuton e merr vendime per te gjitha ceshtjet qe kane te bejne me Shoqerine, perfshi ato te shenuara ne *Nenin 10*, perderisa ato nuk kerkojne ndonje ndryshim ne Statutin e Shoqerise.

Me Vendim te Keshillit Bashkiak do te percaktohet nje perfaqesues nga Bashkia per Asamblene e Aksionereve Tregu i shitjes me shumice te fruta – primeve Korçë SHA.

Mbledhjet e Asamblese duhet te njoftohen nepermjet rrugeve te pershtatshme (poste rekomande, fax, ctj) te pakten 15 dite perpara dates te propozuar per mbledhje. Ftesa per mbledhjen e Asamblese duhet te shenoje vendin, daten, oren si edhe axhenden e diskutimeve. Pervec kesaj, te pakten 15 dite para mbledhjes se Asamblese, Drejtoria duhet t'u dergoje apo te veje ne dispozicion te aksionereve te Shoqerise te gjithe dokumentacionin e nevojshem me qellim qe t'u krijojte atyre mundesine te njihen me ceshtjet qe do te debatohen dhe te formojne nje mendim per administrimin dhe ecurine e biznesit te Shoqerise, sic kerkohet edhe nga legjislacioni ne fuqi.

Gjate mbledhjes se Asamblese, Drejtori ose zevendesi i tij/saj vepron si Sekretar i Asamblese. Ai/ajo mban proces-verbalin per punimet e Asamblese dhe merr masat qe lista e pjesemarresve ne mbledhje dhe vendimet e Asamblese te mbahen shenim ne rregull sic e kerkon ligji ne fuqi.


Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve drejtohet nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose ne mungese te tij nga zevendesi i tij ose nga nje person i zgjedhur nga anetaret e pranishem.

Neni 10

Kompetencat e Asamblese se Zakonshme

Kompetencat e Asamblese konsistojne ne:

- Perpilimin dhe ndryshimin e planeve afatshkurter, afatmesem dhe afatgjate te Shoqerise;
- Percakton perdorimin e fitimeve neto, nese ka;
- Planifikon investimet dhe buxhetin per vitin (vitet) e ardhshem financiar;
- Merr masat e nevojshme per rritjen e kapitalit te shoqerise, nese eshte nevoja;
- Vendos per ndermarrjen e aktiviteteteve te reja, hapjen e filialeve;
- Ngritjen e shoqerive te reja dhe/ose te investoje aksionet ne kapitalin e shoqerive te tjera;
- Vendos ne marrjen e kredive afatgjate dhe/ose afatmesem, nese nevojiten;
- Percakton menyren e likuidimit te Shoqerise dhe emerone nje ose me shume likuidues, pasi te kete percaktuar kompetencat dhe shperblimin e tyre, ne rastet kur Shoqeria shperndahet per arsye objektive apo ligjore.
- Emerone dhe shkarkon anetaret e Keshillit Mbikqyres. Asambleja percakton nje shperblim per pjesmarrjen ne mbledhje te anetareve te Keshillit Mbikqyres.



Neni 11

Keshilli Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres caktohet nga Asambleja e Aksionereve dhe perbehet nga gjashte anetare:

- | | |
|------------------|-----------|
| a. Agim Shehu | (Kryetar) |
| b. Romeo Saraci | (Anetar) |
| c. Selman Telhaj | (Anetar) |
| d. Avni Spaholli | (Anetar) |
| e. Enkes Shundi | (Anetar) |
| f. Vjollca Bimo | (Anetar) |

Kryetar i Keshillit Mbikqyres eshte Agim Shehu. Anetaret e Keshillit Mbikqyres normalisht emerohen per nje periudhe tre vjecare. Ata mund te riemerohen. Asambleja e Aksionereve mund t'i shkarkoje ata nga detyra para perfundimit te mandatit, mbi baze te arsyeve te argumentuara sipas ligjit.

Antaret e Keshillit Mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te punesohen ne Shoqeri.

Keshilli Mbikqyres duhet te mblidhet jo me pak se dy here ne vit dhe shqyrton te gjitha ceshtjet qe kane te bejne me Shoqerine.

Mbledhja e Keshillit Mbikqyres eshte e vlefshme vetem nese jane present te pakten kater anetare. Normalisht, Kryetari i Keshillit duhet te jete prezent. Ne rast se Kryetari mungon, atehere zevendesi i tij/saj vepron ne emer te tij/saj dhe drejton mbledhjen. Ne rastet kur te dy, Kryetari dhe Nenkryetari nuk mund te marrin pjese ne mbledhje, atehere Kryetari cakton nje zevendesues per te vepruar ne emer te tij/saj dhe te drejtoje mbledhjen.

Neni 12

Vendimet e Keshillit Mbikqyres

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres thirren nga Kryetari ose zevendesi i tij sa here qe e kerkon interesi i Shoqerise. Mbledhja e Keshillit Mbikqyres mund te thirret gjithashtu brenda 15 dite pasi Drejtoria ose 1/3 e antareve te Keshillit Mbikqyres i dergon Kryetarit te Keshillit kerkesen me shkrim duke shpjeguar arsyet per thirrjen e mbledhjes. Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres njoftohen ne rruge te pershtatshme (poste, faks, etj) te pakten 10 dite para dates te propozuar per mbledhje, duke shenuar vendin, daten dhe oren e mbledhjes, si edhe axhenden e

diskutimeve. Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres mbahen ne zyrat e Shoqerise apo ne ndonje vend tjeter qe shenohet ne njoftimin e mbledhjes. Keshilli Mbikqyres mban nje regjister ku anetaret hedhin firmen per te evidentuar pjesemarrjen e tyre ne mbledhje. Per diskutimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres mbahet process-verbal, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, nga Kryetari dhe nje anetar i Keshillit, ose ne mungese te Kryetarit, nga dy anetare te Keshillit. Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose zevendesi i tij ose ne mungese te tyre, personi i autorizuar duhet te nenshkruajne vendimet e marra nga Keshilli.

Vendimet e Keshillit Mbikqyres merren nepermjet votimit. Vota e cdo anetari eshte barabarte, dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres merren me shumice votash, me perjashtim te vendimeve ne lidhje me zgjedhjen dhe emerimin e Drejtorit, i cili kerkon votim unanim. Per vendime te zakonshem, ne rast se votat jane te barabarta, atehere Kryetari, ose Zevendesi i tij kane vote percaktuese per te marre vendimin.

Neni 13

Kompetencat e Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres pergjigjet per:

- Ushtron kontroll te vazhdueshem ne administrimin e Shoqerise nepermjet Drejtorise dhe autorizon Drejtorin te kryeje veprime, te cilat nuk mund te behen pa marre me pare miratimin nga Keshilli Mbikqyres.
- Percakton numurin e punonjesve qe punojne me Drejtorin dhe perbejne Drejtorine;
- Emeron Drejtorin dhe punonjesit e tij;
- Nenshkruan kontrata me Drejtorin dhe punonjesit e tij, duke percaktuar pergjegjesite reciproke te tyre ne Drejtori.
- Shqyrton dhe kontrollon veprimtarine e Drejtorise. Keshilli Mbikqyres lejohet ne cdo kohe te kontrolloje gjithe dokumentacionin qe ai e konsideron te nevojshem.
- Siguron nje funksionim te mire dhe korrekt te tregut, ne perputhje me Statutin dhe Rregulloren e Brendshme te tregut;
- I propozon Asamblese planin e investimeve dhe te buxhetit per vitin (vitet) e ardhshem financiar
- Emeron Komitetin Konsultativ te Tregut, i cili ka vetem rol konsultues ne lidhje me te gjitha vendimet dhe aktivitetin e Shoqerise. Ai perbehet nga nente anetare, te cilet jane perfaqesues te institucioneve apo grupeve te interesuar, si me poshte:

a) Bashkia e qytetit te Korçës	1 anetar
b) PMU e ASP	1 anetar
c) Fermeret	2 anetare
d) Tregtaret me shumice	2 anetare
e) Shitesit me pakice	1 anetar
f) Organizatat per Mbrojtjen e Konsumatoreve	1 anetar
g) Institucionet publike per Shendetin dhe Higjenen	1 anetar
- Menyra e funksionimit te Komitetit Konsultativ te Tregut, miratohet me Vendim te Keshillit Mbikqyres.
- Komiteti i pare Konsultativ i Tregut krijohet nga Keshilli i pare Mbikqyres brenda nje viti nga koha e regjistrimit te Shoqerise ne Gjykate, me t'u emeruar anetaret e tij.
- Keshilli Mbikqyres percakton nje shperblim honorar per pjesemarrjen ne mbledhje te anetareve te Komitetit Konsultativ te Tregut.

Neni 14

Drejtoria

Anetaret e Drejtorise emerohen nga Keshilli Mbikqyres. Keshilli Mbikqyres perzgjedh dhe emerohet Drejtorin me vota unanime dhe anetaret e drejtorise me shumice votash.

Anetaret e drejtorise jane ne vartesi te Drejtorit. Anetaret e drejtorise duhet te jene persona fizike; ata nuk mund te jene persona juridike.

Anetaret e drejtorise nuk duhet te jene anetare te Keshillit Mbikqyres. Kur nje anetar i Keshillit Mbikqyres emerohet Drejtor, ose anetar i drejtorise ne Shoqeri, mandati i tij si anetar i Keshillit Mbikqyres mbaron. Drejtori dhe anetaret e drejtorise nuk mund te mbajne funksione drejtuese ne shoqeri te tjera. Keshilli Mbikqyres mund ta shkarkoje nga detyra Drejtorin dhe anetaret e tjere per arsye te justifikuara ligjerisht ose kur ata nuk i kryejne sic duhet detyrat e tyre. Drejtori dhe anetaret e drejtorise normalisht emerohen per nje periudhe tre vjecare, duke perfshire nje vit periudhe prove, ne fund te te cilit Keshilli Mbikqyres mund edhe te vendose te mbaroje kontraten me ata nese shikon se veprimtaria e tyre nuk ka qene e kenaqshme. Kur nje anetar i drejtorise nuk eshte ne gjendje qe ne menyre te vazhdueshme te ndjeke detyrat e tij/saj, Drejtori cakton nje person per zevendesimin e tij/saj. Kryetari i Keshillit Mbikqyres duhet te vihet ne djeni per marrjen e ketyre masave. Nese Drejtori nuk mundet te ndjeke detyrat e tij/saj, Kryetari i Keshillit Mbikqyres cakton nje person per zevendesimin e tij/saj. Keshilli Mbikqyres cakton nivelin e shperblimit per Drejtorin dhe anetaret e drejtorise.

Drejtoria perbehet nga nje anetar. Drejtor i Shoqerise eshte Z. Stefan Barka.

Neni 15

Kompetencat e Drejtorise

Drejtoria pergjigjet per funksionimin e tregut. Drejtoria ka kompetenca te plota te veproje ne emer te Shoqerise. Aktet me te cilat Shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve duhet te nenshkruhen nga anetari me cilesine e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte. Vendimet kryesore per drejtimin e tregut merren nga Drejtori, i cili konsultohet me punonjesit e tjere dhe me Komitetin Konsultativ te Tregut, sic shprehet ne Nenin 20. Edhe anetaret e tjere te drejtorise mund te marrin vendime brenda kuadrit te funksioneve te tyre, sic shprehet ne kontratat perkatese me ata. Ata i raportojne Drejtorit

Drejtori propozon strukturen organizative te Shoqerise dhe ia paraqet ate Keshillit Mbikqyres per miratim. Drejtori i raporton Keshillit Mbikqyres mbi veprimtarine e Shoqerise te pakten cdo tremujor dhe asamblese sa here te jete e nevojshme. Brenda tre muajsh nga mbyllja e vitit financiar dhe pas diskutimeve me Komitetin Konsultativ te Tregut, Drejtori duhet t'i paraqese Keshillit Mbikqyres bilancin vjetor te Shoqerise per ta shqyrtuar, kontrolluar dhe paraqitur per miratim Asamblese.

Drejtori drejton mbledhjet e Komitetit Konsultativ te Tregut. Ai/ajo mund ta therrasin mbledhjen sa here qe e shohin te nevojshme, duke u derguar te gjitha anetareve nje njoftim me shkrim me rruget me te pershtatshme si me faks, poste, etj, te pakten 7 dite para, duke shenuar vendin, kohen dhe ceshtjet qe do te diskutohen ne mbledhje. Drejtori mban proces-verbal per mbledhjet e Komitetit Konsultativ te Tregut, te cilin ua dergon Keshillit Mbikqyres dhe/ose Asamblese. Mbledhjet e Komitetit Konsultativ te Tregut jane te vlefshme vetem nese jane prezent Drejtori dhe shumica e anetareve te tij.

Neni 16


Kontrolli financiar

Kontrasti financiar i Shoqërise kryhet nga dy eksperte kontabel te licensuar, te cilet caktohen nga Asambleja e Pergjithshme dhe kryejne detyren ne perputhje me ligjin.

Neni 17

Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Keshilli Mbikqyres mbikqyr llogarite vjetore qe te jene ne perputhje me ligjin "Per kontabilitetin" dhe harton raportin mbi administrimin.



Neni 18

inventari dhe llogarite vjetore

Shoqeria mban llogari te rregullta mbi asetet e saj, detyrimet, te ardhurat e shpenzimet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ne fund te cdo viti financiar, Drejtori pergatit bilancin dhe deklaraten mbi fitimet dhe humbjet e Shoqërise, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Drejtori pergatit gjithashtu te gjitha raportet administrative te nevojshme ne lidhje me aktivitetin e Shoqërise per periudhat financiare perkatese.

Neni 19

Ekspertet kontabel

Asambleja e pergjithshme emeron ekspertet kontabel, te cilet kane te drejten:

- Ekspertët kanë detyrë të përhershëm, duke përjashtuar çdo ndërhyrje në administrim të verifikojnë librat e llogarisë dhe fondet e shoqërisë si dhe të kontrollojë përshtatjen e kontabilitetit të saj me legjislacionin në fuqi.
- Pergatitin raportet vjetore me te dhenat ekonomike dhe japin mendimet e tyre nese te dhenat ekonomike reflektojne gjendjen ekonomike aktuale te Shoqërise ;
- Informon Keshillim Mbikqyres mbi cdo parregullsi te mundeshme te vene re ne procedura, asetet e Shoqërise dhe qe mund te kete shkaktuar humbje per Shoqërine.

Ekspertet kontabel qendrojnë ne detyre per nje periudhe prej 1(nje) viti.

Ekspertet e pare kontabel emerohen Z. Dhimitraq Pano dhe Z. Bashkim Gjata.

Neni 20

Informimi i organeve të Shoqërisë nga ekspertët kontabël

Ekspertët kontabël të autorizuar u bëjnë të njohur drejtorit dhe keshillit mbikqyres :

- Kontrollat dhe verifikimet që kanë kryer dhe sondazhet e ndryshme që kanë bërë.
- Pjesët e bilancit dhe të dokumentave të tjerë të kontabilitetit në të cilat sipas tyre duhet te ishin bere ndryshime, duke bere gjithashtuedhe të gjitha vërejtjet e duhura mbi metodat e vlerësimit të përdorura për përpilimin e këtyre dokumentave.
- Parregullsitë dhe pasaktësitë që kanë zbuluar
- Përfundimet që rrjedhin nga vërejtjet dhe korrigjimet e mësipërme mbi rezultatet e vitit financiar të mëparshëm.



Neni 21
Prishja e shoqerise

Shoqeria priset nese ka mbaruar kohezgjatja e saj ose ne raste se ka shpallur falimentimin.

Shoqeria likujdohet ne perputhje me dispozitat ligjore per falimentimin dhe **ligjeve nr. 7638, date 19.11.1992 dhe nr. 7667 date 28.01.1993.**

Gjate likujdimit, emri I Shoqerise ndiqet nga shprehja "ne likujdim". Ky emer si dhe emri I likujdatorit pasqyrohet ne te gjitha veprimet dhe dokumentat e leshuara nga Shoqeria tek te-tretet.



Neni 22

Te pergjithshme

Ceshtjet qe nuk jane permendur ne kete Statut, rregullohen sipas dispozitave te ligjit per Shoqerite Tregtare.

Ky statut eshte hartuar ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe dhe pasi u lexua nga aksioneri u nenshkrua prej tij.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj pas marrjes se miratimit nga organet shqiptare kompetente ne baze te ligjit shqiptar ne fuqi.

ROBERT DAMO

KRYETAR I BASHKISE



STATUTI I SHOQERISE

“Tregu shitjes me shumice te fruta-perimeve”

SH.A. Korce

STATUTI I SHOQERISE
"TREGU I SHITJES ME SHUMICE TE FRUTA-PERIMEVE,, KORCE SH.A.

Ne kete statut :

"Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, date 14 04 2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare,,

"Statuti,, eshte statuti i shoqerise

"Aksioner,, eshte aksioner i vetem, si zoterues i aksioneve.

"Dite te plota" ne lidhje me periudhen e nje njoftimi qe nuk e perfshin ditën kur eshte dhene njoftimi dhe ditën per te cilën eshte dhene ose hyn ne fuqi njoftimi.

KREU I

Themelimi, emri, objekti, kohezgjatja, selia.

Neni 1 : Data e themelimit, emri dhe themeluesit.

- Shoqeria krijohet ne formen e Shoqerise Anonime, ne date 04 05 2004.
-
- Emri i saj eshte "Tregu i shitjes me shumice te fruta-perimeve,, Korce, SH. A.
- Themeluesi i Shoqerise eshte Bashkia Korce, ne baze te nenit 95 te ligjit "Per shoqerite tregetare", ndryshuar me ligjin 9901, date 14 04 2008, "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare", me vendim Nr. 27, date 04 05 2004, te Keshilli te Bashkise, Korce (konfirmuar nga Prefektura me shkresen Nr. 829 prot., date 17 05 2004).
-

Neni 2 : Objekti

- Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj dhe te hape filialet e veta ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.
-
- Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete :
- Ngritja dhe funksionimi i tregut te shitjes me shumice te prodhimeve bujqesore te fresketa.
-

Dhenia me qira e hapësirave dhe ambjenteve të tregut, individëve dhe firmave që tregetojnë prodhime bujqësore, kryesisht fruta-perime.

Dhenia me qira e hapësirave dhe ambjenteve individëve dhe firmave që sigurojnë shërbime të ndryshme, për përdoruesit e tregut me shumicë.

Nxitja e shitjes së prodhimeve bujqësore lokale, duke organizuar aktivitetet përkatëse, si panaire, ekspozita, etj.

Shoqëria siguron transparencë për transaksionet tregëtare që zhvillohen brenda tregut me shumicë. Ajo grumbullon dhe shpërndan të dhëna për tregun, tek të gjitha palet e interesuara.

- Shoqëria do të luajë rolin e ndërmjetësit për shkëmbimin e prodhimeve bujqësore duke krijuar aksesë për lidhje kontratash ndërmjet fermerëve dhe tregëtarëve.

Neni 3 Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar mbi 10 vjet.

Neni 4: Selia

Selia e shoqërisë është pranë ish-U.M.B. Korce, Shqipëri, me Nr.kontakti Tel/Fax ++35582243262.

Kreu II

Kapitali I Regjistruar

Neni 5 : Vlerat dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

Kapitali i regjistruar është 275.000.000 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë milion) leke,

i ndarë në 27.500 aksione me vlerë nominale 10.000 (dhjetëmijë) leke secili.

Kontributi është shlyer plotësisht nga aksioneri.

Neni 6 : Zmadhimi dhe zvogëlimi I Kapitalit Themeltar

- Administratori, deri ne 3-vjet, nga data e themelimit te Shoqerise, mund te rrise kapitalin themeltar te Shoqerise . Pas perfundimit te kesaj periudhe, kjo e drejte duhet te rinovohet me shumicen e kualifikuar te votave se Asamblese se Pergjitheshme.
-
- Ne pajtim me ligjin, Asambleja e Pergjitheshme mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me shumicen e kualifikuar se votave, te percaktuara ne fjaline e dyte , pika 1, e ketij neni.
-
-

Kreu III **Asambleja e Pergjitheshme**

Neni 7 : Thirja e Asamblese se Pergjitheshme

- Asambleja e Pergjitheshme thirret nga Administratori, te pakten dy here ne vit. Keshilli Mbikqyres mund te therrase Asamblese e Pergjitheshme ne rastet e parashikuara ne nenin 136 te Ligjit.
-
- Mbledhja e Asamblese se Pergjitheshme thirret nepermjet nje njoftimi te derguar me poste ose poste elektronike (e-mail) drejtuar cdo aksioneri. Njoftimi behet te pakten njezet e nje dite te plota perpara dates se caktuar per mbledhjen.
-
- Mbledhjet e Asamblese se Pergjitheshme jane te pavlefshme ne rast te moskryerjes te paqellimshme se njoftimit apo mos-marrjes se njoftimit te mbledhjes nga personat te cilet kane te drejte te marrin kete njoftim, me perjashtim te rastit kur shoqeria provon se personi i ka dhene shoqerise nje adrese te pasakte.
-

Neni 8 : Mbledhjet e Asamblese se Pergjitheshme.

- Asambleja e Pergjitheshme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorunit te parashikuar nga neni 144 i ligjit .
-
- Keshilli Mbikqyres, cakton nje person si Kryetar te mbledhjes, si dhe nje person per te mbajtur proces-verbalin e mbledhjes.
-
- Administratori ose anetari i Keshillit Mbikqyres, pavaresisht se nuk eshte aksioner, ka te drejten e pjesmarrjes si dhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjitheshme.
-

- ERISE
- Kryetari, me pelqimin e Asamblese se Pergjitheshme te mbledhur ne pajtim me kuorumin e caktuar ne Ligj, mund te shtyje mbledhjen e Asamblese se Pergjitheshme, por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen vetem ato ceshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbleqdhja e meparshme. Kur mbledhja e Asamblese se Pergjitheshme shtyhet te pakten per katermbedhjete dite, njoftimi do te kryhet te pakten shtate Dite te Plota perpara kesaj date dhe ne te do te percaktohet ora dhe vendi i mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi ipergjithshem i rendit te dites. Ne rast te kundert, dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme.
 -
 - Asambleja vendos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk kerkohet ne menyren e duhur nje votim i fshehte.
 -

Neni 9 : Emerimi i eksperteve kontabel te autorizuar

- Me propozim te Keshillit Mbikqyres, Asambleja e Pergjitheshme cakton nje ose me shume persona fizike ose nje shoqeri kontabel te autorizuar si eksperte kontabel te autorizuar te shoqerise, ne pajtim me piken 2 e nenit 135 te Ligjit. Emerimi behet nepermjet nje vendimi te Asamblese se Pergjitheshme te marre me shumice te zakonshme, i cili nese miratohet, sjell emerimin e personit te propozuar si ekspert kontabel te autorizuar te shoqerise.
-
- Gjate mandatit te tyre, ekspertet kontabel te autorizuar mund te largohen nga detyra vetem per shkaqe te aresyeshme. Mendimet e ndryshme per metodat e kontabilitetit apo procedurat e kontrollit nuk perbejne shkaqe te aresyeshme per largimin e eksperteve kontabel te autorizuar.
-
- Eksperti kontabel i autorizuar ose shoqeria e Eksperteve Kontabel te Autorizuar i raporton Keshillit Mbikqyres, per ceshtje kryesore qe rezultojne nga kontrolli financiar dhe ne vecanti, per dobesi te kontrollit te brendshem ne lidhje me procesin e raportimit financiar.
-
- Personat e meposhtem jane Eksperte kontabel te Autorizuar, deri ne mbledhjen e Asamblese se Pergjitheshme.
- Etleva Ashiku
- Ilda Ekonomi
-
-

KREU IV Administratoret



Neni 10 : Emerimi I administratorit

- Keshilli Mbikqyres zgjedh nje person fizik si Administrator te Shoqerise, per nje periudhe trevjecare, ne pajtim me piken 2, te nenit 135, dhe piken 2 te nenit 167 te ligjit. E merimi do te jete individual dhe sipas vendimit te Keshillit Mbikqyres, nese miratohet, sjell emerimin e personit te propozuar si Administrator te Shoqerise.
- Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk mund te caktohen si Administrator. Kufizime te tjera lidhur me emerimin e Administratorit, parashikohen ne piken 2, neni 158 te Ligjit.
- Administratore e shoqerise eshte Znj.Arjana Pupa, e zgjedhur me vendim te Keshillit Mbikqyres.

Neni 11 : Kopetencat e Administratorit

- Politikat tregetare te Shoqerise do te administrohen dhe Shoqeria do te perfaqesohet nga Administratori i cili mund te ushtroje te gjitha koopedencat e tij ne perputhje me parashikimet e pikes 2 te nenit 167, shkronjave "a", "gj", "h" dhe "l" te pikes 1 te nenit 154, dhe pikave 3 dhe 5 te nenit 158 te Ligjit. Detyrat e Keshillit Mbikqyres, ne perputhje me parashikimet e pikes 1 te nenit 167 dhe shkronjave "b", "c", "c", "d", "dh", "e", "e", "f", "g" dhe "l" te pikes 1 te nenit 154 te Ligjit, nuk mund t'u delegohen Administratoreve.
- Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Pergjitheshme dhe te udhezimeve te Keshillit Mbikqyres nuk do te shfuqizojne akte te meparshme te Administratoreve, te cilat do te ishin te vlefshme nese ndryshimi nuk do te ishte kryer ose udhezimi nuk do te ishte dhene.

Neni 12 : Skualifikimi dhe Shkarkimi I Administratorit

- Detyra e Administratorit perfundon ne rast se :
- Personi nuk eshte me si Administrator ne baze te dispozitave te Ligjit, perfshire shkarkimin nga Keshilli Mbikqyres ne pajtim me piken 2 te nenit 167, dhe shkronjen "c" te pikes 2 te nenit 135 te ligjit.
- Personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese
- Personi vuan ose mund te vuaje nga c'rregullime mendore

- Personi jep doreheqjeni nga detyra duke njoftuar shoqerine .

KREU V

Keshilli Mbikqyres

Neni 13 : Emerimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres

- Asambleja e pergjitheshme emeron te pakten tre ose me shume persona fizike, gjithmone ne nje numer tek, jo me te madh se 21, ne cilesine e anetareve te Keshillit Mbikqyres ne perputhje me shkronjen "c" te pikes 2 te nenit 135, pikes 4 te nenit 167 dhe pikes 2 te nenit 155 te Ligjit. Emerimet jane individuale dhe ne perputhje me vendimin e mbledhjes se Asamblese se Pergjitheshme te marre me shumice votash, i cili, nese miratohet, sjell emerimin e personit te propozuar si anetar I Keshillit Mbikqyres. Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te shkarkohen ne cdo kohe nga Asambleja e Pergjitheshme.
- Nuk mund te zgjidhen anetare te Keshillit Mbikqyres, Administratori i shoqerise dhe te shoqerise te te njejtit grup, apo personat e lidhur me ta ne perputhje me parashikimet e pikes 3 te nenit 13 te ligjit.
- Keshilli Mbikqyres i shoqerise perbehet nga :
 - Pellumb Beqiri Kryetar
 - Kristi Ngjela N/Kryetar
 - Vangjush Dishnica Anetar

Neni 14 : Kompetencat e Keshillit Mbikqyres.

- Keshilli Mbikqyres nuk merr pjese ne administrimin e Shoqerise. Keshilli Mbikqyres vezhgon dhe mbikqyr zbatimin e politikave tregetare nga administratori dhe kontrollon pajtushmerine me kerkesat e ligjit dhe te statutit. Detyrat e Keshillit Mbikqyres te percaktuara nga pika 1 e nenit 167, shkronjat "b", "c", "c", "d", "dh", "e", "e", "f", "g", e "l" te pikes 1 dhe 2 te nenit 154 te ligjit nuk mund t'i delegohen Administratorit.
- Keshilli Mbikqyres nuk mund te delegoje asnje nga detyrat te cilat i ngarkohen ne pajtim me dispozitat ligjore.

Neni 15 : Skualifikimi dhe largimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres

- Detyra e anetarit te Keshillit Mbikqyres perfundon ne rast se :
-
- Personi pushon se qeni anetar I Keshillit Mbikqyres ne baze te dispozitave te Ligjit duke perfshire parashikimet e pikes 4 te nenit 167 dhe nenit 1547.
-
- Personi gjendet ne gjendje paaftesie paguese
-
- Personi vuan ose mund te vuaje nga crregullime mendore
-
- Personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine
-
- Ka munguar per me shume se gjashte muaj rradhasi pa lejen e anetareve te tjere te Keshillit Mbikqyres ne mbledhjet e ketij keshilli, te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe Asambleja e Pergjitheshme, me propozim te Keshillit Mbikqyres, vendos ta shkarkoje nga detyra.
-

Neni 16 : Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres

- Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres do te mbahen sipas nevojave te aktivitetit tregetar te Shoqerise.(jo me pak se dy here ne vit)
-
- Vendimet e Keshillit Mbikqyres merren me kuorumin e percaktuar ne piken 5 te nenit 167 dhe nenin 162 te ligjit.
-
- Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres drejtohen nga Kryetari. Ne rast se Kryetari nuk deshiron te drejtoje mbledhjen apo nuk eshte i pranishem, brenda pese minutave nga orari i caktuar per mbledhjen, anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te emerojne njerin prej tyre si Kryetar te Mbledhjes.
-
- Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votave te pjesmarresve. Ne rast numri te barabarte votash, vota e kryetarit do te jete vendimtare.
-
- Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Keshillit Mbikqyres, ose nga persona te cilet veprojne si anetare te Keshillit Mbikqyres, pavaresisht nese behet e ditur ne vijim se emerimi i anetarit te Keshillit Mbikqyres ka pasur mangesi, do te konsiderohen te vlefshme njelloj sikur keta persona te ishin emeruar dhe te ishin cilesuar te vazhdonin detyren si anetare te Keshillit Mbikqyres dhe te kishin te drejte te votonin ne mbledhje.
-
- Vendimi me shkrim i nenshkruar nga te gjitha anetaret e Keshillit Mbikqyres, te cilet kane te drejte te njoftohen per mbledhjet e Keshillit Mbikqyres, eshte njelloj i vlefshem

dhe i efektshem, sikur te ishte miratuar ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres, te mbledhur dhe te zhvilluar rregullisht.

Neni 17 : Kufizime per votimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres

- Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk do te lidhin marreveshje ose votojne ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres mbi ceshtje per te cilat keta anetare kane direkt ose indirekt, nje interes apo detyrim i cili eshte material, qe eshte ose mund te jete ne kundërshtim me interesat e Shoqerise, ne pajtim me nenin 13 te ligjit.
- Ne rast se ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres diskutohet nje ceshtje e lidhur me te drejten e votes se nje anetari te tij, ceshtja mund t'i drejtohet Kryetarit te mbledhjes, perpara perfundimit te mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me cdo anetar te Keshillit Mbikqyres te ndryshem nga ai vet do te jete perfundimtar.

Neni 18 : Proces-verbalet e Keshillit Mbikqyres

- Keshilli Mbikqyres eshte pergjegjes per mbajtjen ne libra te posacem te procesverbaleve
- Te gjithe takimeve te keshillit Mbikqyres, perfshire dhe emrin e Administratorit

Neni 19 : Shperblimi i punes dhe shpenzimet e Administratorit dhe anetareve te Keshillit Mbikqyres

- Administratori dhe anetaret e Keshillit Mbikqyres, shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga Keshilli Mbikqyres dhe te miratuar nga Asambleja e Pergjitheshme ne perputhje me parashikimet e pikes 1 te nenit 160 te ligjit.
- Perfitimet individuale percaktohen nga Keshilli Mbikqyres. Ato duhet te pasqyrojne ne menyre te pershtatshme detyrat e Administratorit dhe anetareve te Keshillit Mbikqyres ne lidhje me skemen e permendur ne piken 1 te ketij neni te statutit dhe gjendjen financiare te Shoqerise.
- Me miratimin e Asamblese se Pergjitheshme, Keshilli Mbikqyres mund te shperndaje shperblime ne para, pensione, sigurime ose forma te tjera, per ata administratore ose anetare Keshilli Mbikqyres te cilet kane pasur detyra dhe kane punuar me pare per Shoqerine, dhe Keshilli Mbikqyres mund te paguaje kontribute ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla.

Administratorit dhe anetareve te Keshillit Mbikqyres u paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, hotelit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me permbushjen e detyrave te tyre.

KREU VI **Dividentet**

Neni 20 : Dividentet dhe krijimi I rezervave

- Ne perputheje me dispozitat e Ligjit, shoqeria me shumice te zakonshme te votave te Asamblese se Pergjitheshme mund te deklaroje dividentet ne perputhje me te drejtat e aksionerit, sipas nenit 128 te Ligjit.
- Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje aksion nuk prodhon interesa kundrejt Shoqerise nese nje gje e tille nuk parashikohet ne te drejtat e aksionit.
- Cdo dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet brenda dymbedhjete vjeteve nga data e maturimit, ne rast se vendoset nga Asambleja e Pergjitheshme, do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete me e detyruar qe ta paguaje ate.
- Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjate vitit financiar paraardhes, duke zbritur shpenzimet, shoqeria kalon ne rezerven ligjore , te pakten 5% te kesaj vlere.

KREU VII **Prishja dhe njoftimet**

Neni21 : Prishja dhe likuidimi

- Ne rast likuidimi te Shoqerise, vendimi merret nga Asambleja e Pergjitheshme me vendim te posacem ne perputhje me ligjin ne fuqi.
- Asambleja e Pergjitheshme cakton likuidusin , i cili zbaton te gjitha procedurat sipas ligjit.

Neni 22 : Te pergjitheshme

Ceshtjet qe nuk jane trajtuar ne kete statut, rregullohen sipas dispozitave te ligjit 9901, date 14 04 2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare,,,

- Ky statut hartohet ne kater kopje ne gjuhen shqipe dhe pasi u lexua nga aksioneri u nenshkrua prej tij.
- Shoqeria do te vazhdoje aktivitetin e saj ne perputhje te ketij statuti dhe ligjit ne fuqi.

**Per aksionerin e vetem
Keshilli i Bashkise
Kryetari
Gjergji Pendavinji**

